



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr.04/2023

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Manushe Karaçi kryesuese, Adnan Konushevcu dhe Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor për përmbaruesit privat, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore lidhur me veprimet përmbarimore në lëndën përmbarimore, P.nr.191/2020, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike, në të cilën ka prezantuar përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat Fadilete Hoxha - Blakqori, dhe në mungesë të Udhëheqësit i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira si përpilues i raportit të datës 23.01.2023, në mungesë të ftuar me rregull për seancë, dhe Përmbaruesi Privat, me datën 13.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, Nr.16/2022 i datës 20.01.2023, lidhur me iniciimin e procedurës disiplinore ndaj përmbaruesit privat si organ përmbarues, i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore **si i pa bazuar.**

II. Përmbaruesi Privat si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës për Territorin e Gjykatës Themelore, **nuk është përgjegjës** për shkelje të pretenduara disiplinore gjatë veprimeve të ndërmarra në lëndët përmbarimore P.nr.191/2020.

A r s y e t i m

Departamenti për Profesione të Lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbarim Privat, me datë 20.01.2023, nga Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për

Profesione të Lira Petrit Reçica dhe Admir Sadiku Zyrtar për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira, për kryerjen e inspektimit të veçantë për sa i për ketë punës së Përmbauesit Privat. Në raport për inspektim të veçantë konstatohet se përmbauesi privat ka vepruar në kundërshtim me Ligjin nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaimore dhe në kundërshtim me udhëzimin administrativ për tarifatat dhe shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për Përmbaues Privat MD.nr.06/2014. Me propozim që të iniciohet procedura përmbaimore dhe të shqiptohen masa disiplinore ndaj përmbauesit privat në proporcion me shkeljen e bërë.

Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbaimin Privat, me datë 27.01.2023, ka paraqitur në Komision Disiplinor Raportin Përfundimtar, ndaj përmbauesit private, si organ përmbaues, lidhur me veprimet e ndërmarra nga përmbauesi privat në lëndën përmbaimore P. nr. 191/2019, me propozim që të ndërmerren veprimet e nevojshme lidhur me këtë rast.

Përmbauesi Privat, në seancë dëgjimore e ka kundërshtuar në tërësi raportin për iniciimin e procedurës disiplinore, pas inspektimit të veçantë nga Udhëheqësi i Divizionit për Mbikëqyrjen e Ligjshmërisë së Punës për Profesione të Lira. Sipas përmbauesit privat shkelja që pretendohet së është bërë me rastin e shkresës së datës 09.02.2022 me emërtim "Urdhër për Thirrje", është e pa bazë sepse ajo shkresë vetëm titullin e ka në atë mënyrë ngase e ka përmbajtjen e konkluzionit, dhe për me tepër procedimi i përmbaimit se si është bërë në rastin është shumë me e favorshme ekonomikisht për procedurën, andaj konsideron përmbauesi privat se nuk ka bërë asnjë lloj shkelje. Me propozim për komisionin që iniciimit i procedurës dicipline sipas raportit lëndor të refuzohet i pabazuar.

Neni 367 paragrafi 1 pikat nga 1 deri 11, i Ligjit të Procedurës Përmbaimore, i përcakton shkeljet përmbaimore për përmbauesit privat, si janë në vijim:

- 1.1. Nëse përmbauesi privat tejkalon autorizimet e besuara me këtë ligj;
- 1.2. Nëse gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbauesi privat nuk i përmbahet ligjit;
- 1.3. Nëse përmbauesi privat gjatë procesit të emërimit nuk ka zbuluar në mënyrë të qëllimshme pengesat ligjore të cilat janë kusht i emërimit të tij;
- 1.4. Nëse përmbauesi privat ka shkelur detyrat e parashikuara me këtë ligj duke rrezikuar besimin në paanshmërinë e tij dhe në veprimet të cilat ai i ndërmerret;
- 1.5. Nëse përmbauesi privat ndërmerret veprime në procedurë pavarësisht arsyeve për përjashtim;
- 1.6. Nëse përmbauesi privat shkel detyrën e mbajtjes së sekretit zyrtar;

- 1.7. Nëse përmbartuesi privat kërkon kompensim më të lartë se sa ai i paraparë në tarifë;
- 1.8. Nëse përmbartuesi privat pa shkaqe të arsyeshme refuzon aftësimin profesional;
- 1.9. Nëse përmbartuesi privat nuk mban evidencat për lëndët e përmbartimit në të cilat ai punon apo evidencat e lëndëve në të cilat ai/ajo punon nuk janë në rregull;
- 1.10. Shkelja e detyrave të përcaktuara me dispozitat tjera dhe
- 1.11. Nëse përmbartuesi privat në pajtim me aktin e odës nuk e paguan anëtarësinë.

Pas seancës dëgjimore dhe dëgjimit të palëve, analizimit të dispozitës së lartcitur, Komisioni Disiplinor, me kujdes dhe vëmendje ka vlerësuar të gjitha pretendimet e palëve dhe ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim që Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore, për këto arsye:

Komisioni Disiplinor, vlerëson se Përmbartuesi Privat, nuk është përgjegjës për asnjërën nga shkeljet e lart cituar të nenit 367 të LPP-së, sepse në këtë rast përmbartuesi privat nuk ka bërë ndonjë tejkalim të autorizimit të dhënë me ligj apo ndonjë zvarritje të procedurës me qëllim që të shkaktohen shpenzime të procedurës, prandaj komisioni vlerëson se përmbartuesi privat, nuk është përgjegjëse për veprimet e ndërmarra përmbartimore në rastin lëndor.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr.04/2023 datë 13.04.2023

Kryesuese e Komisionit Disiplinor
 Manushe Karaçi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar në nenin 374 par. 5 të LPP-së.